

DEKRET
Nr.1242, datë 5.10.1995

**PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.7678, DATË 3.3.1993 “PËR AKCIZAT NË
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, NDRYSHUAR ME LIGJIN NR.7797, DATË 23.2.1994**

Në mbështetje të nenit 28, pika 19, të ligjit nr.7491, datp 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

DEKRETOJ

:

Neni 1

Në ligjin nr.7678, datë 3.3..1993 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, ndryshuar me ligjin nr.7797, datë 23.2.1994, në nenin 3, në paragrafin e parë, shkronja “d” ndryshohet si vijon:

“Energji elektrike.....50, duke përjashtuar disa përdorues të sektorëve kryesorë të ekonomisë, sipas përcaktimit të Këshillit të Ministrave.

Në nenin 3, në paragrafin e tretë, fjalën “Për energjinë elektrike 50 për qind” ndryshohen si vijon:

“Për energjinë elektrike 50 për qind, duke përjashtuar disa përdorues të sektorëve kryesorë të ekonomisë...”.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet e tij nga data 1 korrik 1995.

Kundërfirmohet
Kryeministri
Aleksdandër Meksi

Presidenti i Republikës
Sali Berisha

Miratuar me ligjin nr.8029, datë 14.11.1995 të Kuvendit Popullor